

**VENDIM**  
**Nr.356, datë 18.8.1992**

**PËR KRIJIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË ENERGJETIKËS**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Komitetit të Energjisë në vartësi të Këshillit të Ministrave. Komiteti i Energjisë është organ Kolegjial e vendimor me funksion ndërminstor dhe me objekt veprimtarie: të hartojë politikën e përgjithshme të zhvillimit energjetik të vendit; të studiojë e përcaktojë përpjestimet e zhvillimit ndërmjet llojeve të energjive; të studiojë, propozojë e të ndjekë futjen në përdorim të të gjiha kapaciteteve të lira energjetike, të burimeve e të llojeve të reja të energjive, si dhe përdorimin racional të tyre; të studiojë tregun ndërkombëtar të energjisë e të bashkërendojë punën për të shfrytëzuar çdo përfitim të mundshëm në shkëmbimin e energjive; të përfaqësojë politikën e qeverisë në fushën e energjisë në organizmat ndërkombëtare.

2. Për kryerjen e detyrave Komiteti i Energjisë ka aparatin e tij, i cili vepron sipas rregullores së miratuar nga kryetari i komitetit.

Kryetari i Komitetit Kombëtar të Energjisë emërohet nga Kryesia e Këshillit të Ministrave, kurse punonjësit e aparatit emërohen nga Kryetari i Komitetit.

3. Kryetari i Komitetit të Energjisë, brenda datës 15 shtator 1992, të paraqitë për miratim në Këshillin e Ministrave përbërjen, detyrat e të drejtat e Komitetit të Energjisë, marrëdhëniet e tij ndërminstrore etj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**